

Letra e Dashurisë së Atit

Thirrja e Zemrës së Atit nga Zanafilla deri tek Zbulesa

Fëmija im...

Ndoshta Ti nuk më njuh, por unë di gjithcka rreth teje ...Psalmi 139:1 E di kur ti ulesh dhe kur ti ngrihesh ...Psalmi 139:2 I njoh mirë të gjitha rrugët e tua ...Psalmi 139:3 Madje di edhe numrin e flokëve në kokën tënde ...Mateu 10:29-31 Pasi ti u bërë në imazhin tim ...Zanafilla 1:27 Në mua ti jeton, lëviz dhe ke ekzistencën tënde ...Veprat e Apostujve 17:28 Ti je fëmija im ...Veprat e Apostujve 17:28 Të kam njohur që përpara se të lindje ...Jeremia 1:4-5 Të kam zgjedhur ty që kur planifikova krijimin ...Efesianët 1:11-12 Ti nuk ishe një gabim, pasi gjithë ditët e tua janë shkruar në librin tim ...Psalmi 139:15-16 Unë caktova kohën e saktë të lindjes tënde dhe vendin ku do të jetoje ...Veprat e Apostujve 17:26 Ti je krijuar në mënyrë të mrekullueshme ...Psalmi 139:14 Të formova në barkun e nënës tënde ...Psalmi 139:13 Dhe të solla në jetë në ditën e lindjes tënde ...Psalmi 71:6 Më kanë keqprezantuar ata që as nuk më njohin ...Gjoni 8:41-44 Nuk jam i largët dhe zemërak. Unë jam shprehja e plotë e dashurisë ...1 Gjoni 4:16 Madje është dëshira ime të derdh dashurinë time në ty ...1 Gjoni 3:1 Thjesht sepse ti je fëmija im dhe unë jam ati yt ...1 Gjoni 3:1 Unë të ofroj më shumë se ç'mund të të ofronte ati yt tokësor ...Mateu 7:11 Sepse unë jam Ati i përkryer ...Mateu 5:48 Cdo dhuratë të mirë që ti merr, vjen nga dora ime ...Jakobi 1:17 Sepse unë jam siguresi yt dhe plotësoj gjithë nevojat e tua ...Mateu 6:31-33 Plani im për të ardhmen tënde ka qënë gjithmonë plot shpresë ...Jeremia 29:11 Sepse unë të dua ty me një dashuri të pashtershme ...Jeremia 31:3 Mendimet e mia për ty janë aq të panumërta sa kokrrizat e rërës ...Psalmi 139:17-18 Dhe unë gëzohem për ty me britma gëzimi ...Sofonia 3:17 Kurrë nuk do të ndaloj duke të të bërë mirë ...Jeremia 32:40 Ti je thesari im i cmuar ...Eksodi 19:5 Unë dëshiroj të të jap begati me gjithë zemrën dhe shpirtin tim ...Jeremia 32:41 Dhe unë dua të të tregoj ty gjëra madhështore dhe të mrekullueshme ...Jeremia 33:3 Nëse më kërkon me gjithë zemrën tënde, do të më gjesh ...Ligji i Përtërirë 4:29 Gjej gëzimin tënd në mua dhe unë do të plotësoj dëshirat e zemrës tënde ...Psalmi 37:4 Sepse unë jam ai që t'i ka dhënë këto dëshira ...Filipianët 2:13 Unë mund të bëj gjëra që janë përtej imagjinatës tënde ...Efesianët 3:20 Sepse unë jam ngushëlluesi yt më i madh ...2 Thesalonikasve 2:16-17 Jam gjithashtu Ati që të ngushëllon ty në të gjitha shqetësimet e tua ...2 Korintasve 1:3-4 Kur je i lënduar, unë jam pranë teje ...Psalmi 34:18 Ashtu si bariu kujdeset për qengjin e tij, ashtu edhe unë të kam mbajtur pranë në zemrën time ...Isaia 40:11 Do të vijë një ditë kur unë do të fshij cdo lot nga sytë e tu ...Zbulesa 21:3-4 Dhe do të largoj tutje cdo dhimbje që ti ke vuajtur në këtë tokë ...Zbulesa 21:3-4 Unë jam Ati yt, dhe unë të dua ty ashtu si dua birin tim, Jezusin ...Gjoni 17:23 Dashuria ime për ty u shfaq me Jezusin ...Gjoni 17:26 Ai është përfaqësi i vërtetë i qënies time ...Hebrenjve 1:3 Ai erdhi të të tregojë se unë jam me ty, jo kundër teje ...Romakeve 8:31 Dhe të të tregojë se unë nuk i numëroj mëkatet e tua ...2 Korintasve 5:18-19 Jezusi vdiq që ti dhe unë të mund të pajtohemi ...2 Korintasve 5:18-19 Vdekja e tij ishte shprehja më e madhe e dashurisë sime për ty ...1 Gjoni 4:10 Unë dhashë gjithcka që doja në mënyrë të fitoja dashurinë tënde ...Romakeve 8:31-32 Nëse ti pranon dhuratën e birit tim Jezus, ti më pranon mua ...1 Gjoni 2:23 Dhe asgjë nuk do të na ndajë kurrë më nga dashuria ime ...Romakeve 8:38-39 Eja në shtëpi dhe unë do të bëj festën më të madhe që është bërë ndonjëherë në qiell ...Luka 15:7 Gjithmonë kam qënë Ati, dhe gjithmonë do të jem Ati ...Efesianët 3:14-15 Pyetja ime është...A do të jesh ti fëmija im? ...Gjoni 1:12-13 Unë po të pres ...Luka 15:11-32

**Me dashuri, Ati Yt.
Zoti i Gjithpushtetshëm**